**AKT THEMELIMI**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**"UNIT 4"**

---

Sot, ne Tirane, me daten 14.09.2024, me cilesine e ortakut themeluese te shoqerise:

**Kushtrim Kryeziu**, i datelindjes 19.08.1980, lindur ne Prishtine, Kosove, dhe banues ne Kosove, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i paisur me pasaporte biometrike nr. Nr. P02252148, ka vendosur themelimin e shoqerise tregtare **"UNIT 4"**.

Me nenshkrimin e ketij Akti Themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruesi dhe themeluesi i saj merr persiper te realizoje e te respektoje te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga klauzolat e meposhtme, te cilat do te specifikohen gjeresisht ne Statutin e shoqerise:

**THEMELIMI I SHOQERISE**

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **"UNIT 4".**

(me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku themelues i saj.

**FORMA E SHOQERISE**

Shoqeria **"UNIT 4" ,** me poshte e referuar si "Shoqeria", eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar krijuar ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite Tregtare", dhe rregullohet prej ketij ligji, dhe statutit te shoqerise si dhe prej cdo dispozite tjeter ligjore te aplikueshme.

**II - EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA**

**Neni 1**

**Emri i shoqerise**

Emri i shoqerise eshte "**UNIT 4**". Ne çdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:

(i) fjala "me pergjegjesi te kufizuar" apo "sh.p.k"

(ii) numri i saj i regjistrimit

(iii) selia

**Neni 2**

**Selia**

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Rr. "Mihal Duri", Tirane, **Shqiperi**, Pallati "Albontario" Dyqani Nr. 10, Tirane.

Përfaqësues me prokurë

**Neni 3**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte me afat te pacaktuar, duke filluar prej momentit te regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

## III. - OBJEKTI I SHOQERISE

**Neni 4**

**Objekti**

Objekt i veprimtarise do te jete:

- Zhvillim territorial dhe/ose ndërtimor
- Projektim dhe zbatim te punimeve te ndertimit, rikonstruksione, mbikqyrje, kolaudim punimesh, punime montimi, ne godina civile, industriale, bujqesore, turistike, shoqerore, objekte sportive, vepra ujore, kanalizime te ndryshme, rruge, ura, vepra arti, punime komunale, mjedisore, interiere, punime te sistemeve ngrohje-ftohje, dhe punime te te gjitha llojeve ne fushen e ndertimit dhe montimit.
- Eksport, import, tregetim materiale te ndryshme ndertimi dhe mallra te ndryshme.

## IV. KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 100.000 (njeqind mije) leke.
Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1(nje) kuote me nje vlere nominale te barabarte me 100.000 leke secila, te cilat zoterohen, si me poshte: Kushtrim Kryeziu baras me 1 kuote me vlere 100.000 Leke.

**Neni 6**

**Organizimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryeje, **Z. Kushtrim Kryeziu**, i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Ortakeve.

**ORTAKU THEMELUES**
**KUSHTRIM KRYEZIU**

**PERFAQESUAR ME PROKURE NR. 1180 REP, NR. 424 KOL, DATE 13.08.2024,**
**NGA SHEFIKATE AGARAJ**